

**AKT THEMELIMI**

1. – Personi juridik “Ankor” sh.p.k me seli ne Elbasan, Shqiperi, me numer unik identifikimi NUIS M03505202R mbështetur ne ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe ne legjislacionin shqiptar ne përgjithësi,
2. --Z.Fatjon Seitaj, atësia Rakip, I datëlindjes 28.02.1991, lindur ne Fier dhe banues në Tiranë , shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi te plotë juridike për të vepruar, mbajtës I kartes se identitetit me nr 034683946 dhe me nr.personal J10228026L,

vendosen si vijon:.

**KREU II - EMERTIMI, SELIA DHE AFATI I SHOQERISE**

**NENI 1**

- 1.1 Te themelojë shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar, për te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e te cilës rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar- ne fuqi.

**NENI 2**

- 2.1 Shoqëria do te emërtohet "PROSOL" sh.p.k.

**NENI 3**

- 3.1 Shoqëria do te ketë Selinë e saj ne Elbasan Bradashesh BRADASHESH Rruga "Ura e Kushes", zona kadstrale 2124, pasuria nr.7/1/1, njesi ND2 93.7m2
- 3.2 Selia e shoqërisë mund te transferohet.

**NENI 4**

- 4.1 Shoqëria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Afati mund te ndryshohet me vendim te Asamblesë se Ortakeve.
- 4.2 Shoqëria “PROSOL” sh.p.k gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

**NENI 5**

- 5.1 Shoqëria “PROSOL” sh.p.k do te ketë si objekt:

Prodhim i energjise diellore .Tregtim i energjise nga burime te rinovueshme.Tregtim i impianteve/paneleve fotovoltaike,sisteme per mire menaxhimin e energjise, Ofrimi i konsulences dhe asistences teknike per projektimin, mirembajtjen, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, dhe te çdo materiali tjetër ndihmes te sistemit dhe rjetit te energjise diellore,Konsulence dhe cdo aktivitet qe lidhet me fushen e energjise

Import mallra e pajisje te teknologjise ne fushen energjitikes etj, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante fotovoltaike e forma te tiera te prodhimit te energjise nga burime te rinovueshme.

Gjithashtu, Shoqëria mund te kryeje çdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

#### **NENI 6**

- 6.1 Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesën e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e përfitojnë ortakët e saj.
- 6.2 Ortakët themelues përballojnë humbjet shoqërisë deri ne kufirin e vlerës se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne bankat e Shtetit Shqiptar.
- 6.3 Kapitali themeltar për vazhdimin e aktivitetit te shoqërisë është ne shumen 1,000,000 (një milion) leke, qe i takon ortakeve themelues si me poshtë:
  - (a) Personi Juridik “Ankor” Sh.p.k zotëron 1 kuote, me vlere 50 % te kapitalit.
  - (b) Fatjon Seitaj, i cili zoteron 1 kuote, me vlere 50 % te kapitalit.
- 6.4 Fitimet qe do te evidentohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave mund te ndahen si vijon:
  - (a) Fondi rezerve.
  - (b) Shpërblimi qe i takon ortakeve themelues.

#### **NENI 7**

- 7.1 Shoqëria mund te hyje ne veprimtari te përbashkëta me shoqëri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti atë te shoqërisë.


#### **NENI 8**

- 8.1 Veprimtaria shoqërisë mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

### **KREU III - TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT**

#### **NENI 9**

- 9.1 Ortaku gëzon këto te drejta kryesore:
  - (a) Administrimin e veprimtarisë ne përputhje me akt themelimin dhe statutin.
  - (b) Pjesëmarrjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasi te veprimtarisë se shoqërisë e parashikuar ne statutin e saj.
  - (c) Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblesë dhe organet e tjera te shoqërisë.



- (d) Te heqë dore nga shoqëria. Heqja dore nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqërisë.
- (e) Te marri pjese ne organet e shoqërisë qe janë ose mund te krijohen nëpërmjet përfaqësuesit te tij ose vete.
- (f) Te emëroje dhe te shkarkoje përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

9.2 Ortaku ka këto detyrime kryesore:

- (a) Te depozitoje kuotën e tij dhe kuotën suplementare ne përputhje me akt themelimin dhe statutin.
- (b) Te marri pjese ne administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve te krijuara nga vete ata.
- (c) T'i japi shoqërisë te dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti te veçante lidhur me veprimtarinë e saj.
- (d) Te kryeje detyrat për realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqërisë.
- (e) Ka detyrimin nëse heq dore nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 3 muaj përpara dhe duke çduar te drejtën e zgjedhjes.
- (f) Te kryeje shërbimet e domosdoshme për arritjen e objektivave te shoqërisë dhe realizimin e funksioneve te saj.

## **KREU IV – ADMINISTRIMI**

### **NENI 10**

10.1 Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakeve.

### **NENI 11**

- 11.1 Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm.
- 11.2 Ne shoqërinë "PROSOL" sh.p.k administrator i shoqërisë do te jete Z. Ervis Deda, atësia Hiqmet, shtetas Shqiptar, lindur ne Elbasan, me date 26.11.1983 dhe banues ne Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit me nr. Personal I31126050U madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar.
- 11.3 Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vjetësh financiare.
- 11.4 Me miratimin e ortakeve mund te emërohen administratore dhe përfaqësues te tjerë te shoqërisë. Administratoret emërohen për një kohëzgjatje prej 5 (pese) vjetësh financiare me përjashtim te rasteve te dorëheqjes ose shkarkimit te parakohshëm.
- 11.5 Administratori ka te gjitha kompetencat për te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqërisë dhe ne emër te saj nëpërmjet akteve qe janë ne përputhje me objektin e veprimtarisë se shoqërisë me përjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo te tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo për faj te tij gjate administrimit te shoqërisë



## KREU V - MBYLLJA E SHOQËRISË

### NENI 12

- 12.1 Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bere nga ortaku, kur gjate tre vjetëve nuk rezulton rentabël si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqërisë.
- 12.2 Shoqëria shpërndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

### NENI 13

- 13.1 Kur shoqëria likuidohet Asambleja e ortakut emëron likuidatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë se saj ne çastin e miratimit te këtij bilanci te likuidimit. Komisioni i Likuidimit përbehet nga një ose tre natarë. Pasuritë qe janë vene ne dispozicion te shoqërisë me te drejte shfrytëzimi, shiten ne vartësi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat veprimtarisë se shoqërisë e te filialeve te saj dhe fondet financiare ndahen ndërmjet ortakeve ne përpjesëtim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat për kreditoret.

### NENI 14

- 14.1 Kur pushon veprimtaria e një filiali, për efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakeve.
- 14.2 Likuidimi i filialeve behet njëlloj si për shoqërinë.
- 14.3 Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarisë se filialit te likuiduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqërisë pasi to jene bere pagesat likuidatorëve.

### NENI 15

- 15.1 Dispozita te hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen ne statutin e saj.

Ky Akt-Themelimi nënshkruhet me vullnet te lire ne 1 kopje identike ne gjuhen shqipe, dhe secili nga ortaket do te marre një kopje.

## ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Ankor Sh.p.k

Fatjon Seitaj

---

Përfaqësuar nga Z. Ervis Deda,  
Administrator i Ankor shpk